

Forum Kulturor
BULETIN INFORMATIV
Janar 2015

Varg e Vi – Ekspozita “Tale of Childhood”
Janar 2015

ARTAN HAJRULLAHU / AVNI RUDAKU / AVNI SHKODRA / BESIM BAFTIU /
DIN AZIZI / JETON MUJA / KUSHTRIM ZEQRIRI



**TALE
OF CHILDHOOD
du Collectif
Varg e Vi**

.....
Du 17/01 au 07/02/2015

Vernissage
vendredi 16 janvier
à 18h30

Atelier
samedi 31 janvier
à 14h30

Concert
samedi 07 février
à 18h30

<http://collectifdenface.blogspot.fr/>
collectifdenface@gmail.com




*L'Atelier du Collectif d'en Face / 49, rue St Vivien à Rouen

TALE OF CHILDHOOD **Collectif Varg e Vi**
du 17/01 au 07/02/2015

Visible les jeudis et vendredis de 18H00 à 20H / les samedis de 14H00 à 18H00
et 7 jours sur 7 depuis la vitrine
ou sur rendez-vous (collectifdenface@gmail.com)

- ▶ **Vernissage**
vendredi 16 janvier à 18h30
- ▶ **Atelier**
samedi 31 janvier à 14h30
- ▶ **Concert**
samedi 07 février à 18h30

ARTAN HAJRULLAHU
AVNI RUDAKU
AVNI SHKODRA
BESIM BAFTIU
DIN AZIZI
JETON MUJA
KUSHTRIM ZEQRIRI


<http://collectifdenface.blogspot.fr/>
collectifdenface@gmail.com

VARG E VI



Varg e Vi ekspozon në hapësirën alternative për Art Bashkëkohor “Collectif Denface” në Reuen – Francë. Hapja bëhet më 16 Janar, 2015 në ora 18:30. Kosovën do ta përfaqësojnë artistët si: Artan Hajrullahu, Din Azizi, Kushtrim Zekiri, Avni Rudaku, Besim Baftiu dhe Jeton Muja.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,115>

Arpolis Center – Punëtori 3 ditore “Siguria e integruar për aktivistet e reja”
Janar 2015



Artpolis Center organizon punëtori 3 ditore: "Siguria e integruar për aktivistet e reja"

Gjatë këtij seminari do të krijohet një hapësirë e sigurtë për të reflektuar mbi mirëqenien dhe sigurinë personale, menaxhimin e stresit dhe traumës, planifikimi i kohës personale dhe tema tjera që lidhen me mirëqenien e aktivistëve dhe si ndikon ajo në punën dhe sigurinë e organizatës.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,111>

40 Bunar Fest – Loja në PlayStore
Janar 2015



40 Bunar Fest lansoi lojën e tyre në PlayStore. Të gjithë adhuruesit e rëshqitjes në ujë me goma tani e tutje do ta kenë mundësinë që me anë të androidëve të tyre të luajnë lojën e tyre të preferuar.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,112>

Qendra Multimedia – Thirrje për aplikim “Prishtina nuk ka lum”
Janar 2015



Qendra Multimedia në bashkëpunim me TRADUKI dhe Goethe Institute fton të gjithë shkrimtarët kreativ, poetët, eseistët, opinionistët, përkthyesit dhe dramaturkët nga Europa Juglindore dhe Gjermania të aplikojnë në programin shkrimtarët në vendbanim “Prishtina nuk ka lum” 2015, në Prishtinë, Kosovë. Afati i fundit për aplikim është 25 Shkurt, 2015.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,113>

Orgaizatave të Pavarura të Kulturës në Malishevë
Janar 2015



Në Komunën e Malishevës u mbajt takimi i përbashkët në mes të Forumit Kulturor dhe Organizatave të Pavarura Kulturore të Malishevës, në të cilin u diskutua për nivelin e zhvillimit të kulturës në vend, bashkëpunimin ndërmjet organizatave kulturore dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe u diskutua për mundësinë e rjetëzimit lokal të këtyre organizatave kulturore dhe përfshirjen e tyre në punën e Forumit Kulturor.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,9,110>

Dokufest & Anibar - Kinematë e Prizrenit dhe Pejës në mesin e më të bukurave në botë
Janar 2015



Tre kinematë e DokuFest dhe dy të Anibar janë radhitur në listën e 15 kinemave më të bukura në botë, duke u vënë në të njëjtën listë ku janë edhe kinematë me veçanti kulturore dhe arkitekturore nga vende të zhvilluara të botës.

Për më shumë, shih: <http://forumikulturor.net/?page=1,6,114>